



MËSIMI I GJUHËS AMTARE
HERKUNFTSSPRACHENUNTERRICHT (HSU)

SHQIP/ALBANISCH

Çfarë është mësimi i gjuhës së origjinës (MGJA)?

Përse është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë gjuhën e tyre amtare në një shkollë gjermane?

Çfarë roli luan MGJA në shkollë?

Mësimi i gjuhës amtare në Hamburg ofrohet nga Ministria e Arsimit dhe Formimit Profesional. Mësimi i gjuhës amtare iu ofrohet nxënësve që rriten me dy ose më shumë gjuhë njëkohësisht. Ai është shpërndarë në bazë të planit mësimor për gjuhët amtare, në shkollat fillore, në shkollat e mesme si dhe në gjimnaze.

Pothuajse 40% e nxënësve të Hamburgut nuk rriten me gjuhën gjermane, por janë fëmijë dygjuhësh ose shumëgjuhësh. Ky potencial për njohuritë gjuhësore dhe kulturore promovohet, konsolidohet dhe zgjerohet në MGJA/HSU. Ashtu si nxënëset dhe nxënësit mësojnë gjuhën arsimore gjermanisht në shkollë, po kështu në MGJA/HSU ata fitojnë aftësi gjuhësore arsimore që tejkalojnë gjuhën e përditshme që flitet në shtëpi. Nxënëset dhe nxënësit gjithashtu marrin strategji dhe njohuri që e bëjnë më të lehtë për të mësuar gjuhë të tjera - duke përfshirë edhe gjuhën gjermane. Vetëbesimi i tyre në lidhje me dygjuhësinë ose shumëgjuhësinë e tyre forcohet.

Rezultatet në mësimin e gjuhës amtare vlerësohen në bazë të planeve kornizë dhe nota përfshihet në dëftesë. Kjo u mundëson nxënësve dhe nxënësve të marrin pjesë në mësimin e tyre në shkollë, me njohuri dhe aftësi që kanë fituar në MGJO/HSU, në nivelin mësimor deri në maturë.

Si është i organizuar MGJA/HSU në shkollë? Në cilat gjuhë ofrohet MGJA/HSU?

Nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të autoriteteve të shkollës, ekzistojnë klasat e mëposhtme në shkollat fillore si dhe në ato të gjimnazeve (shih pasqyrën në faqen 4):

MGJA si një ofertë shtesë mësimi (MGJA/HS Lloji A)

MGJO mund të frekuentohet në shkollat fillore, shkollat e mesme dhe gjimnaze si një mundësi shtesë mësimore nga klasat parashkollore deri në klasat 12 ose 13. Mësimi shpesh zhvillohet pasdite dhe zakonisht përfshin tre orë në javë. Pjesëmarrja është vullnetare për nxënëset dhe nxënësit, por pas regjistrimit është e detyrueshme për të paktën një vit shkollor. Mësuesi i lëndës vlerëson nxënësin me notë në dhe ajo regjistrohet në dëftesë.

Këtu përfshihen gjuhët: Shqip, Arabisht, Gjuha boshnjake, Gjuha kineze, Farsi, Italisht, Polonisht, Gjuha Portugeze, Rusisht dhe Turqisht (që nga viti shkollor 2020/21).

MGJA si gjuhë shtesë (gjuhë e huaj 2 ose 3, MGJA Lloji B)

Gjuhët e amtare mund të zgjidhen nga nxënësit si lëndë e zgjedhur por me pjesëmarrje të detyrueshme në shkollat e mesme dhe në gjimnaze. Numri i orëve mesimore korrespondon me numrin e orëve të gjuhëve të tjera. Mësimi i gjuhës vlerësohet me notë. Shpesh ora e mësimit zhvillohet si mundësi e njëjtë, njësoj për nxënëset dhe nxënësit për të gjitha shkollat dhe zakonisht duhet të rezervohen detyrimisht të frekuentohet deri në klasat e 10. Gjuhët mund mësohen edhe në vitet përfundimtare të maturës edhe mund të zgjidhen si lëndë provimi të maturës.

Këtu përfshihen gjuhët: Arabisht, Gjuha kineze, Farsi, Italisht, Polonisht, Gjuha Portugeze, Rusisht dhe Turqisht (që nga viti shkollor 2020/21)

MGJA si lëndë kryesore në nivelin e studimit (MGJA Lloji D)

Krahas gjuhës gjermane dhe matematikës, është e rëndësishme që edhe një gjuhë tjetër të merret si lëndë kryesore për provimin përfundimtar. Lënda kryesore mund të jetë gjithashtu një nga gjuhët e prejardhjes të renditura më poshtë. Kushti kryesor është që gjuha të zotërohet të paktën në nivelin B1, d.m.th. gjuha duhet të jetë ferkuentuar minimalisht për dy vite psh. nga klasa e 8 deri në fund të klasës së 9. Nëse shkolla nuk e ofron mësimin përkatës për gjuhën amtare, nxënësi duhet të ndjekë kursin e gjuhës edhe jashtë orarit mësimor në shkollat e rrethit (pasditeve) të cilat e ofrojnë atë.

Gjuhët që mund të merren si lëndë kryesore përfshijnë Arabisht, Gjuha kineze, Farsi, Italisht, Polonisht, Gjuha Portugeze, Rusisht dhe Turqisht (që nga viti shkollor 2020/21).

Kur dhe ku zhvillohet MGJA?

Shkolla ofron informacionet e duhura për nivelet e gjuhëve amtare. Nëse nuk ofrohet mësimi i gjuhës amtare në shkollën e tyre, nxënësit mund të marrin pjesë në një shkollë tjetër, ku ofrohet mësimi i gjuhës amtare. Informacionet rreth dhe formularët e regjistrimit janë në dispozicion në shkollë ose në faqen e internetit të departamentit *Steigerung der Bildungschancen*.

Ekziston gjithashtu një përmbledhje e azhurnuar e të gjitha shkollave që ofrojnë mësimdhënie të gjuhëve amtare: <https://www.hamburg.de/steigerung-der-bildungschancen/14243862>.

Informacione të mëtejshme – përfshirë edhe se cilat shkolla ofrojnë MGJA – mund të gjenden këtu:



Kush jep MGJA?

MGJA në përgjegjësinë e autoritetit për shkollën dhe formimin profesional jepet nga mësuesit e shkollës. Si rregull, këta mësues janë folëse apo folës të gjuhës amtare. Përveç veprimtarive të tyre mësimore, mësuesit e gjuhës amtare kanë për detyrë të komunikojnë gjuhën dhe kulturën. Ndër të tjera, ata këshillojnë prindërit dhe kujdestarët se si mund t'i mbështesin fëmijët e tyre gjatë të mësuarit në shtëpi dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth karrierës shkollë dhe orientimit në karrierë.

A mund të vendosen oferta të mëtejshme në gjuhën e origjinës?

MGJA - Mësimi i gjuhës amtare do të ofrohet nga shkollat me kërkesë të prindërve. Është e nevojshme që numri minimal i nxënësve të regjistruar të jetë deri në 15 nxënës. Për ta do të vihet në dispozicion një mësimdhënës i/e kualifikuar.

Si mund të marrësh pjesë në mësimet e gjuhës së origjinës?

Për të marrë pjesë kërkohet një regjistrim, gjë që më pas ju detyron të merrni pjesë rregullisht. Opsioni i mësimi të gjuhës amtare fillon pas pushimeve verore. Regjistrimi për vitin shkollor vijues kërkohet para pushimeve verore. Informacionet e detajuara dhe formularët e regjistrimit janë në dispozicion në shkollë ose në faqen e internetit *Rritja e mundësive arsimore* (<https://www.hamburg.de/steigerung-der-bildungschancen/14243862>).

A ka ndonjë ofertë tjetër në gjuhën amtare në shkollat në Hamburg?

Krahas mësimi të gjuhës amtare, që ofrohet drejt për së drejti nga Ministria e Arsimit, ka edhe oferta nga Institucione dhe Shoqata të tjera.

oferta MGJA nga verikom


orë mësimore e konsullatës!

Suportuesi verikom – Shoqata për komunikim dhe edukim ndërkulturor e.V ofron oferta qendrore për disa gjuhë amtare më pak të zakonshme. Këto orë mësimi bazohen në planet kornizë, por nuk vlerësohen me notë në certifikatë. Prandaj – në ndryshim nga MGJA, në përgjegjësinë e autoritetit të shkollës – një performancë e mirë në MGJA nuk mund të kompensojë ndonjë notë tjetër (të keqe) në certifikatë. *Gjuhët e ofruara aktualisht përfshijnë Shqip, Armenisht, Dari, Farsi, Pashtunisht, Vietnamez dhe Twi (Status: viti shkollor 2020/21). Oferta mësimore të mëtejshme mund të vendosen sipas kërkesës.*

Disa konsullata organizojnë orë mësimore plotësuese në gjuhën amtare (të ashtuquajturat "Orë mësimore të konsullatës"). Kjo zhvillohet jashtë orarit të rregullt të mësimi. Mësuesit dërgohen nga vendet e origjinës dhe punojnë sipas programit mësimor nga vendi i origjinës. Ora mësimore nuk vlerësohet e rëndësishme për certifikatën, por përfshihet si koment në certifikatë. *Gjuhët e ofruara janë aktualisht Greqisht, Gjuha Kroate, Portugeze, Serbisht, Spanjisht dhe Turqisht (që nga viti shkollor 2020/21).*



Llojet e mësimdhënies së gjuhës
amtare në shkollat e Hamburgut
(shih gjithashtu faqen 2 të kësaj fletëpalosjeje)



Informata në gjuhët

► Shqip ► Arabisht

► Gjuhë boshnjake ► Kinezçe

► Anglisht ► Farsi ► Frëngjisht

► Italisht ► Polonisht ► Gjuhë portugeze

► Rusisht ► Turqisht

mund të gjeni në internet:

<https://www.hamburg.de/steigerung-der-bildungschancen/>



Informacione të mëtejshme
Freie und Hansestadt Hamburg
Behörde für Schule und Berufsbildung
Amt für Bildung – Abteilung B3:
Referat: Steigerung der Bildungschancen

Winterhuder Weg 29, 22085 Hamburg
E-Mail: steigerung-der-bildungschancen@bsb.hamburg.de
Web: <https://www.hamburg.de/steigerung-der-bildungschancen/>